



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1345/1 Prot.

Tiranë, më 06 / 10 / 2020

V E N D I M

Nr. 128, Datë 06 / 10 / 2020

Bazuar në informacionin e marrë nga z. P.S, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: *“Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”*, nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara”*, me Urdhrin nr. 57, datë 18.05.2020 filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me vendosjen e tarifës vjetore të shkollimit për studentët e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, për vitin akademik 2019-2020.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Bazuar në informacionin e marrë nga z. P.S, Komisioneri filloi procedurën për ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me vendosjen e tarifës vjetore të shkollimit për studentët e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në zbatim të Vendimit Nr. 778, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave *“Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” të ndryshuar”*.

Në shkresën datë 10.03.2020, Z. P.S në mes të tjerash informon Komisionerin se: *“Bazuar në VKM-në nr.288, datë 21.05.2018, i ndryshuar, studentët e universiteteve publike, që kanë mesataren mbi 6, paguajnë gjysmën e tarifës vjetore të shkollimit. Në llogaritjen e mesatares duhen futur vetëm pikëkreditet, për të kaluar vitin akademik. Ndryshe nga ajo që është parashikuar në VKM-në e sipërcituar, Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës, me Vendimin*

nr. 80 datë 07.02.2020 ka tejkaluar kompetencat e njohura në ligj, duke vendosur kritere shitesë mbi VKM-në nr.228, datë 21.05.2018, i ndryshuar, duke kërkuar që studentët të shlyejnë të gjitha detyrimet e vitit akademik, dhe duke përjashtuar të gjithë ato studentë që kanë plotësuar kushtin e vendosur në VKM-në nr. 288, datë 21.05.2018, i ndryshuar, por jo atë të vendosur nga Universiteti i Shkodrës. Bordi i Administrimit të Universitetit, me Vendimin Nr.110 datë 20.02.2020 “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Administrimit Nr.277, datë 14.08.2019” ka refuzuar aplikimin e vendimit të senatit akademik, duke njohur përfitimin e të gjithë studentëve që kanë mesatare mbi 6 me/ose provime të mbartura. Por tek pika 1 është vendosur se në llogaritjen e mesatares, duhen llogaritur provimet që nuk janë frekuentuar, si notë pakaluese 4 (katër). Ankuesi informon se universitetet e tjera publike (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës¹ dhe Universiteti i Durrësit²) kanë rregulluar vendimarrjet e tyre dhe kanë njohur të drejtën e studentëve për të përfituar nga VKM-ja e sipërcituar. Interpretimi i bërë nga Universiteti i Shkodrës ka vendosur studentët e Universitetit të Shkodrës në pozita të pabarabarta krahasuar me studentët e universiteteve të tjera publike të cilët përfitojnë reduktimin e tarifës së shkollimit sipas VKM-së së sipërcituar”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

¹ Referuar Njoftimit të Administratorit të Fakultetit të Shkencave të Naturës të Universitetit të Tiranës, z. R.Skënderi, në zbatim të VKM-së nr.788, datë 26.12.2018, pika 5. Studentët e programeve të studimit të Ciklit të Parë dhe të Ciklit të Dytë të cilësuar përsëritës sipas Rregullores së UT-së, nuk paguajnë tarifë shkollimi.

² Referuar Vendimit nr. 46, datë 11.02.2020 “Për një shtesë në vendimin nr.8, datë 17.01.2020 “Mbi përcaktimin e statusit “Student Përsëritës”” të Senatit Akademik të Universitetit të Durrësit, pika 1. Bazuar në përcaktimin e statusit student përsëritës me vendim të Senatit Akademik nr. 8, datë 17.01.2020, këta studentë të cilët kanë deri në 3 provime të mbartura nuk do të paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik përkatës.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 587/1, datë 18.05.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes.

Me shkresën nr. 1470/1, datë 11.06.2020, Universiteti i Shkodrës në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Senati akademik, duke u bazuar në nenin 3/3/ç të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera përcaktohet: “Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës:ç) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj....” nënin 38/1/a, ku përcaktohet: “1. Funksionet e Senatit Akademik janë: a. Garanton autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve.....” dhe duke u mbështetur dhe në rregulloren e studimit të USH (ku ju kujtojmë se kreditet për kalim në UT dhe UD janë më të larta nga ato në USH), me Vendimin nr.80, datë 07.02.2020 “Për një shtesë në Vendimin nr. 253, datë 17.07.2019, ka vendosur: Të saktësojë se për efekt zbatimi që përfitues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e parë të studimeve do të jenë ato studentë të cilët rezultojnë me notë mesatare të ponderuar mbi 6.0 dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës”. Po ashtu me Vendimin nr. 110, datë 20.02.2020 të Bordit të Administrimit të USH “Për një ndryshim në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 277, datë 14.08.2019” është vendosur: “Përfitues të masës 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e parë të studimeve do të jenë ato studentë të cilët rezultojnë me notë mesatare të ponderuar mbi 6. Tek kjo mesatare do të llogariten edhe notat negative 4, si dhe provimet që nuk frekuentohen do të llogariten si notë pakaluese 4”. Me anë të këtij relacioni ju sqarojmë se vendimmarrja e dy organeve drejtuese në universitet, ka qenë e ndryshme dhe gjithashtu theksojmë se me vendimin e BA është rritur numri i studentëve që kanë përfituar reduktim tarife të shkollimit. Duke u njohur dhe me vendimet e universiteteve të tjera (me përjashtim të atyre ku kërkuesi P.S ka relatuar), vendimet e USH-së dhe universiteteve të tjera, kanë qenë të ndryshme nga njëra tjetra, gjë që pasqyron autonominë universitare të çdo universiteti”.*

Me shkresën nr. 1470, datë 11.06.2020, Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës (BA) në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Pika 1 e Vendimit të BA nr. 110/2020, përcakton lidhur me llogaritjen e mesatares së ponderuar për efektet e zbatimit për përfitim të reduktimit të tarifës se “tek kjo mesatare do të llogariten edhe notat negative 4, si dhe provimet që nuk frekuentohen do të llogariten si notë pakaluese 4”. Nëpërmjet përcaktimit të bërë në këtë pikë BA ka disponuar që të trajtojë në mënyrë të njëjtë studentët që janë futur në provim dhe kanë marrë 4, me studentët që nuk janë futur në provim fare, duke mos realizuar detyrimin e studentit që të studiojë dhe të futet në provime për t’u vlerësuar dhe në këtë mënyrë nuk kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës. Për të dy këto kategori studentësh, lënda përkatëse është “përsëritëse” dhe në këtë këndvështrim efekti është i njëjtë dhe ata gjenden në të njëjtat pozita në fund të vitit akademik për mesataren e të cilit mund të përfitojnë reduktim tarife, për më tepër të dy këto kategori studentësh njësoj duhet të japin*

lëndën riprovim në të njëjtat data të vitit akademik pasardhës. Vendimmarrja e BA është bërë edhe në frymën e VKM-ve të dala në Dhjetor 2018 për efektet e reduktimit të tarifave, disa prej të cilave i referohen shprehimisht shlyerjes së të gjitha detyrimeve të vitit akademik paraardhës (përgaritja dhe hyrja në provime është pjesë e detyrimeve akademike të studentëve dhe jo braktisja e provimeve). Gjatë mbledhjes së BA u diskutua sërish që, nëse do të disponoheshim ndryshe, studentët jo-kalues do të trajtoheshin ndryshe dhe do mund të diskriminoheshin në raport me studentët mos-pjesëmarrës të lëndës, të cilët njësoj si ata duhet ta japin lëndën për riprovim në të njëjtat data të vitit akademik pasardhës. Në analizën e BA paraqitet parësore trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminues i studentëve brenda USH sesa në raport me studentët e dy universiteteve të tjera publike, ndërkohë që nuk ka informacion se si mund të kenë vendosur gjithë universitetet e tjera publike në këtë aspekt dhe mund t'i kenë interpretuar në mënyrë të njëjtë VKM-të dhe llogaritjen e mesatares së ponderuar”.

- Me shkresën nr. 895, datë 02.07.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga 11 Institucione të Arsimit të Lartë Publik, lidhur me zbatimin e VKM-së nr.778, datë 28.12.2018.

Nga 11 kërkesa për informacion të dërguara rezulton se kanë kthyer përgjigje 9 IAL (Universiteti Politeknik, Universiteti i Mjekësisë, Universiteti Bujqësor, Universiteti i Sporteve, Universiteti i Durrësit, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Gjirokastrës dhe Universiteti i Korçës), ndërsa Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Arteve nuk kanë kthyer përgjigje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të vlerësuar situatën e tarifave shkollore të Universitetit të Shkodrës ka marrë në analizë informacionin e dërguar nga 10 IAL⁴, në lidhje me kërkesat e bëra nga Komisioneri me shkresën nr. 895, datë 02.07.202, në të cilën ka kërkuar informacionin, si më poshtë:

1. Cili student konsiderohet përsëritës. Sa pikë kredite duhet të ketë grumbulluar studenti për të kaluar nga viti I-rë në vitin e II-të dhe sa pikë kredite nga viti i II-të në vitin e III-të.
2. A paguan tarifë vjetore shkollimi, studenti përsëritës?
3. A paguan tarifë vjetore shkollimi, studenti që ka mbaruar vitin e III-të dhe ka provime të mbartura. Nëse po, në cilat raste.
4. Për efekt të llogaritje së notës mesatare, studentët që nuk frekuentojnë provimin (nuk marrin pjesë në provim) me çfarë note i llogarisni?

Referuar përgjigjeve të dhëna nga IAL, për pyetjen 1 (një), mbi kreditet që duhet të ketë grumbulluar studenti për të kaluar nga viti I-rë në vitin II-të, u vlerësua se: 7 IAL (UP, UM, UB, US, UE, UV, UGJ) kanë vendosur si kriter për të kaluar, 30 pikë kredite, 2 IAL (UK dhe USH)

⁴ Universiteti Politeknik (UP), Universiteti i Mjekësisë (UM), Universiteti Bujqësor (UB), Universiteti i Sporteve (US), Universiteti i Durrësit (UD), Universiteti i Elbasanit (UE), Universiteti i Vlorës (UV), Universiteti i Gjirokastrës (UGJ), Universiteti i Korçës (UK), Universiteti i Shkodrës (USH).

kanë vendosur si kriter, 20 pikë kredite, ndërsa studentët e Universitetit të Durrësit nuk kanë kriter numrin e krediteve të fituara gjatë vitit akademik pararendës. Lidhur me përgjigjen mbi kreditet që duhet të ketë grumbulluar studenti për të kaluar nga viti II-të në vitin III-të, u vlerësua se: 3 IAL (UE, UGJ dhe UK) kanë vendosur si kriter për të kaluar, 60 kredite, 2 IAL (UP dhe UV) kanë vendosur si kriter 80 kredite, 3 IAL (UM, UB dhe US) kanë vendosur si kriter, 90 kredite, Universiteti i Durrësit nuk ka kriter numrin e krediteve të fituara gjatë vitit akademik pararendës dhe Universiteti i Shkodrës ka si kriter kalimi 25 kredite⁵ nga viti që ndjek.

Referuar përgjigjeve të dhëna nga IAL, për pyetjen 2 (dy), nëse studenti përsëritës paguan tarifë vjetore shkollimi, 9 IAL u përgjigjën se studentët e klasifikuar si përsëritës, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet, ndërsa Universiteti i Durrësit ka të parashikuar se, studentët të cilët kanë deri në 3 provime të mbartura nuk do paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik përkatës.

Referuar përgjigjeve të dhëna nga IAL, për pyetjen 3 (tre), nëse duhet të paguajë tarifë vjetore shkollimi, studenti që ka mbaruar vitin e III-të dhe ka provime të mbartura, 5 IAL (US, UV, UGJ, UK dhe USH) u përgjigjën se studentët duhet të paguajnë tarifë të plotë shkollimi, 3 IAL (UP, UB dhe UE) u përgjigjën se studentët duhet të paguajnë vetëm për lëndët që kanë për të dhënë provim, Universiteti i Mjekësisë informoi se, studenti i vitit të III-të paguan tarifën vjetore të shkollimit kur ka mbi 30 kredite të pa marra për provime të mbartura dhe kur studenti ka nën 30 kredite të pa marra për provime të mbartura nuk paguan tarifën vjetore të shkollimit, ndërsa Universiteti i Durrësit ka të parashikuar se, studentët të cilët kanë deri në 3 provime të mbartura nuk do paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik përkatës.

Referuar përgjigjeve të dhëna nga IAL, për pyetjen 4 (katër), mbi llogaritjen e notës mesatare për studentët që nuk frekuentojnë provimin, 3 IAL (US, UE dhe USH) u përgjigjën se, studentët që nuk kanë frekuentuar provimin, lëndët e pashlyera i llogariten me notën 4 (katër). Universiteti Politeknik u përgjigj se, studenti që nuk paraqitet në provim i shënohet në fletën e provimit cilësimi “Nuk u Paraqit” dhe nuk i shënohet notë. Universiteti i Mjekësisë u përgjigje se, notë mesatare e ponderuar, konsiderohet nota nga 5 deri 8.99, për provimet e marra me vlerësim pozitiv të vitit paraardhës. Universiteti Bujqësor u përgjigj se, kur studenti që nuk paraqitet në provim, procesverbali plotësohet me statusin “Nuk Fiton” ose “Nuk u Paraqit”. Vlerësimi me këtë status për këtë kategori studentësh, duke konsideruar metodologjinë e përdorur nga RASH, në sistemin ESSE 3 nuk llogaritet në mesatare. Universiteti i Durrësit u përgjigj se, për të gjithë studentët të cilët nuk klasifikohen përsëritës, nota mesatare përllogaritet duke marrë në konsideratë të gjitha detyrimet akademike sipas kurrikulës së programit të studimit. Në rast se studenti nuk e ka frekuentuar lëndën apo nuk ka marrë pjesë në provim ai vlerësohet me 0 (zero) kredite të fituara. Universiteti i Vlorës u përgjigj se, studenti që nuk paraqitet në provim merr shënimin NP në transkript dhe në sistem. Mesatarja e transkriptit në këtë rast nuk e llogarit këtë lëndë, por kjo nuk është mesatarja e vitit akademik, sepse në këtë rast studenti nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit akademik. Universiteti i Korçës u përgjigj se, për efekt të llogaritjes së notës mesatare, sekretaritet mësimore nuk llogarisin notat e lëndëve të cilat studenti nuk i ka

⁵ Referuar nenit 34 të Rregullores së Studimeve në Universitetin e Shkodrës.

frekuentuar pasi dhe vetë sistemi elektronik ESSE 3 nuk i gjeneron këto nota. Notat e studentëve që nuk e kanë frekuentuar provimin llogariten në rastin kur llogaritet kalueshmëria e studentëve.

Përsa më sipër, Komisioneri analizoi situatën e sjellë në vëmendje, lidhur me tarifat e shkollimit për studentët e Universitetit të Shkodrës, parë kjo në respektim të zbatimit të legjislacionit vendas. Kështu:

- Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqet e parashikuar në të”*.
- Neni 3, pika 3, e Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon shprehimisht se:

3. Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës:

- a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;*
- b) për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;*
- c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;*
- ç) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj;*
- d) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre”*.

Në këtë kontekst, vihet re se nëpërmjet dispozitës së sipërcituar, ligji përcakton se institucionet publike të arsimit të lartë, kanë të drejtë për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit. Në këtë dispozitë është përcaktuar e drejta e autonomisë financiare të institucioneve të arsimit të lartë, e cila garantohet, krahas të tjerash, edhe nëpërmjet të drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit. Tarifat e studimit përcaktohen përmes akteve të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e organeve kolegjiale në IAL-të publike.

- Në nenin 37 dhe 47 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: *“Senati Akademik është organi më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij”*, ndërsa në nenin 47 përcaktohet se: *“Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij”*.

Në pikën 1 të VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018 *“Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës*

vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” të ndryshuar”, përcaktohet se: “Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, për vitin akademik 2018-2019 dhe në vijim, paguhet nga studentët në masën 50% të vlerave të pasqyruara në tabelën nr.1, që i bashkëlidhët këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.....”. Në pikën 1.1 përcaktohet: “Studentët, të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti akademik 2019-2020 e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit.....”. Ndërsa në pikën 3 të vendimit përcaktohet se: “Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet”.

- Në shkresën nr. 1036, datë 06.02.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbi zbatimin e VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018, drejtuar 12 IAL, në mes të tjerash MASR-ja ka informuar se: *“Mënyra e përlllogaritjes së notës mesatare, me provime të mbartura apo jo, është vendim që duhet të merret nga organet drejtuese të IAL-ve publike”.*
- Në zbatim të VKM-së së sipërcituar, Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës me Vendimin nr. 110, datë 20.02.2020 “Për një ndryshim në vendimin e BA nr. 277, datë 14.08.2020” ka vendosur që: *“Të ndryshojë, për efekt zbatimi, që përfitues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e parë të studimeve do jenë ata studentë të cilët rezultojnë me notë mesatare të ponderuar mbi 6. Tek kjo mesatare do të llogariten edhe notat negative 4 (katër), si dhe provimet që nuk frekuentohen, do të llogariten si notë pakaluese 4 (katër)”.*

Referuar informacionit të dërguar nga IAL-të vërehet se të gjitha vendim-marrjet e këtyre institucioneve janë të bazuar në vendimet e marra nga organet drejtuese të tyre, si Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit si dhe janë të mbështetur në Rregulloren e Studimeve dhe Statutin e IAL-ve.

Në analizë së të dhënave të disponuara nga IAL dhe në respektim të problematikës së ngritur nga P.S, Komisioneri vlerëson se institucionet e arsimit të lartë në respektim të legjislacionit të sipërcituar e kanë bërë vendim-marrjen në respektim të të drejtës së këtyre institucioneve për autonomi akademike dhe financiare.

Nga analiza e të dhënave vërehet se IAL-të kanë vendim-marrje të ndryshme për çështje të ndryshme si në aspektin e pikë krediteve që duhen të këtë studenti për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin po ashtu dhe lidhur me vlerësimin e studentit që nuk merr pjesë në provim. Kështu shumica e IAL-ve kishin vendosur si kriter për studentin, për të kaluar nga viti I në vitin e II, 30 pikë kreditë, ndërkohë që Universiteti i Shkodrës ka të vendosur si kriter 20 kredite.

Lidhur me problematikën e ngritur, nëse studentët përsëritës duhet të paguajnë tarifë vjetore shkollimi, vlerësohet se të gjitha IAL-të kanë të parashikuar në vendim-marrjet e brendshme se

studentët përsëritës duhet të paguajnë tarifë vjetore shkollimi, përjashtojt nga ky interpretim vetëm vendim-marrja e Universitetit të Durrësit që parashikon se studenti që ka deri në 3 provime të mbartura nuk paguan tarifë vjetore shkollimi.

Lidhur me problematikën e ngritur se si llogaritet nota e studentit që nuk merr pjesë në provim për efekt të notës mesatare, vlerësohet se jo vetëm Universiteti i Shkodrës i vlerëson me notën 4 studentët që nuk marrin pjesë në provim por janë dhe Universiteti i Sporteve dhe i Elbasanit që i trajton njësoj këto studentë.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se studentët e Universitetit të Shkodrës nuk janë vendosur në pozita të pabarabarta krahasuar me studentët e universiteteve të tjera publike, lidhur me kushtet dhe kriteret e analizuara, pasi rezulton se IAL-të nëpërmjet organeve të tyre drejtuese kanë vendosur vetë mbi interpretimin e VKM-së 778/2018, dhe nuk ka një interpretim unik nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që të mund të vendoste rregulla të njëjta për të gjitha institucioneve të arsimit të lartë publik, në zbatim të VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018 *“Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” të ndryshuar”*. Përkundrazi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka informuar IAL-të se mënyra e llogaritjes së notës mesatare është vendim që duhet të përcaktohet nga organet drejtuese të IAL-ve.

Në përfundim të sa më lart, Komisioneri vlerëson se, Vendimi nr. 110, datë 20.02.2020 i Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës është bërë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi dhe është tërësisht kompetencë e këtij organi vendosja e kriterëve financiarë dhe administrativë.

Nga ana tjetër, Komisioneri vëren se implanti rregullator i Arsimit të Lartë midis Ligjit, akteve nënligjore dhe akteve rregullatore të vetë IAL-ve, në bazë të parimit të autonomisë së IAL-ve, mund të gjenerojë situata të ndryshme e për rrjedhojë jo të barabarta midis tyre. Kjo, jo domosdoshmërisht krijon premisa për diskriminim kundrejt studentëve të një IAL-je në krahasim me një tjetër, pasi i rëndësishëm është që vlerësimi që i bëhet studentëve të vendoset mbi kriterë aftësie. Lidhur me këtë, vlerësimi me notën 4 (katër) të studentëve të cilët nuk janë paraqitur fare në provim ngre dyshime të forta ligjshmërie, pasi në këtë rast studenti efektivisht nuk është duke u vlerësuar për aftësinë e tij akademike por për një zgjedhje që ai bën në lidhje me lëndët konkrete dhe programin e tij të punës.

Ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/3, parashikon se: *“Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”*.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 3/3, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për rrjedhojë dhe Vendimi nr. 110, datë 20.02.2020 i Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës, nuk është diskriminues.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/3, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të studentëve të Universitetit të Shkodrës në krahasim me studentë të universiteteve të tjera, lidhur me zbatimin e VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018 *“Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” të ndryshuar*”, nga ana e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës.
2. Rekomandimin e IAL-ve (Universitetin e Shkodrës, Universitetin e Elbasanit dhe Universitetin e Sporteve) për rikonsiderimin e vlerësimit me notën 4 (katër) të faktit të mospjesëmarrjes së studentit në provim, duke mos e përllogaritur atë për efekt të mesatares.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA